

VENDIM
Nr. 435, datë 2.7.2014

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE, NË BUXHETIN E VITIT 2014,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si më poshtë vijon:

a) Në programin 09120, “Arsimi bazë”, të pakësohet fondi 97223048 (nëntëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e njëzet e tremijë e dyzet e tetë) lekë.

b) Në programin 09240, “Arsimi i mesëm profesional”, të pakësohet fondi në vlerën 38826200 (tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtëmijë e dyqind) lekë.

c) Në programin 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, të shtohet fondi në vlerën 136049248 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e dyzet e nëntëmijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama